

VENDIM
Nr. 119, datë 4.4.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“AEE” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4 pika 1, germa “e”, 5 pika 1, germa “e”, 10 pikat 1 dhe 3 dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 998/4 prot, datë 30.3.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “AEE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “AEE” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 998/1 prot., datë 27.3.2023, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike.

- Duke qenë se shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovim për të dyja licencat e saj, por vlefshmëria e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “AEE” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 209, përfundon më datë 27.9.2023 dhe aplikimi për rinovimin e kësaj licence sipas rregullores në fuqi duhet të bëhet brenda datës 27.3.2023, ERE me e-mailin e datës 30.3.2023, protokolluar me nr. 998/2 prot., datë 30.3.2023 i kërkoj shoqërisë që të saktësojë kërkesën e saj për rinovim.

- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 998/3 prot., datë 30.3.2023, shoqëria ka saktësuar kërkesën e saj për aplikimin për rinovim vetëm të licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Data e përfundimit të vlefshmërisë së licencës së tregtimit nr. 425, seria T18, është 27.9.2023. Sa konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj më datë 27.3.2023, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, ku përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur); shtojca 1/I; si dhe duhet të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe pagesat e rregullimit në ERE.

- Shoqëria ka depozituar në ERE mandatin për pagesën e aplikimit, të kryer më datë 27.3.2023, sipas përcaktimeve të aneksit A, të rregullores. dhe rezulton që shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “AEE” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:

- Neni 16 “Rinovimi i licencës”, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”. Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “AEE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 210, datë 27.9.2018.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Maksim Shuli